REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE PUBLIKE
DHE PRIVATIZIMIT
Drejtoria Juridike

# URDHER

**Nr.264 date 9.7 1999**

## PER
## TRANSFERIMIN E AKSIONEVE TE SHOQERISE ANONIME "ELEKTRIKU" ELBASAN TEK SHOQERIA ANONIME "KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE" TIRANE

Ne baze te nenit 2 te Ligjit nr.7926 date 20.04.1995 "Per transforminin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare" (ndryshuar me akte te tjera), me cilesine e zoteruesit te aksioneve ne shoqerite anonime "Korporata Elektroenergjitike Shqiptare" Tirane dhe "Elektriku" Elbasan, perkatesisht ne masen 100% dhe 70% dhe te nenit 11 te statutit te shoqerise anonime "Elektriku" Elbasan,

**Urdheroj:**

**1.** Te transferohen te gjitha aksionet e zoteruara nga shteti ne shoqerine anonime "Elektriku" Elbasan tek shoqeria anonime "Korporata Elektroenergjitike Shqiptare".

**2.** Transferimi i aksioneve ne perputhje me piken 1 te ketij urdheri te perfundoje brenda dates ___________ .

**MINISTRI**

**Ylli BUFI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E EKONOMISE PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT TIRANE

12665

# RELACION

GJYKATES SE RRETHIT
TIRANE

Sipas ligjit nr. 7926 dt.20.04.1995 "Per transformimin e ndermarjeve ne shoqeri tregtare ", ne nenin 7 te saj thuhet se "rregjistrimi i shoqerive qe krijohen nga transformimi i ndermarjeve duhet te kryhet brenda dates 31.08.1995. Pas kesaj date te gjitha ndermarrjet qe nuk jane rregjistruar brenda ketij afati kalojne nen kujdestarine e Drejtirise se Shoqerive Publike ne Ministrine e Financave.

Duke u nisur nga sa me siper, mund te themi se paraqitja e dokumentacionit nga ana e ndermarjes Elektrike Shperndarese Elbasan.

nuk eshte paraqitur ne afatin e percaktuar ne ligj,per arsye objektive si:

1. Komisionet e vleresimit nuk e kane perfunduar ne kohe rivleresimin e ndermarjes.

2. Kajne pasur veshtiresi ne marrjen e gent-planit te ndermarjes ne seksionet e urbanistikes se rrethit.

3. Percaktimi i vleres se tokes per m2,per kete ndermarje, nga ana e seksioneve te finances se urbanistikes se rrethit.

Per keto arsye ju kerkojme te beni rregjistrimin e kesaj ndermarjeje si shoqeri tregetare.

**D R E J T O R I**

**DREJTORISE SE SHOQERIVE PUBLIKE TIRANE**

**BERZH PIRANIAN**

12665

Proçes-verbal

Sot më dt. 24-10-97 unë gryftoj'a Marjana Deda thirra ekspertin.

Eksperti: Andrea Kristo, i biri i Pandit dt 1951, banues Rr. Daniel Gjurmyatni Nr-3 Elbasan.

i cili pasi u pyet tha:

Jam caktuar si ekspert kontabël për reformimin e bilancit të shoqërisë "Shpërndarja Energjisë Elektrike Elbasan" nga Ministria Financave në bazë të vendimit të KM. 311 dt. 12-6-1997. "Për transformimin e Nd. shtetërore në shoqëri tregtare,,

- Nuk kam asnjë lloj interesi të kjo shoqëri.

- Zbatësoj kushtet e parashikuara në nenet 168 e 169 dhe 1638 "Për shoqëri tregtare.

Eksperti
Andrea Kristo

Gryftare
Marjana Deda